

PREFEKTURA DIBER

Ardhur  
Nr. 472 dt. 24.04.23



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I QARKUT DIBËR

81/1.

VENDIM

Nr. 01 Datë 13.04.2023

PËR

MIRATIMIN E TREGUESVE BUXHETOR TË VITIT 2022

Mbeshtetur ne, Ligjin nr.139/2015 "Per veteqeverisjen vendore", neni 82 pika 2, Ligjit nr. 68/2017 "Per financat e veteqeverisjes vendore", neni 33 pika 2, Ligjit nr.9936, date 26.06.2008 "Per menaxhimin e sistemit buxhetore ne Republiken e Shqiperise", i ndryshuar, Ligjit nr. 2020 "Per buxhetin e vitit 2022", në zbatim të Udhëzimit Plotësues nr. 9, dt. 20.03.2018 "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit" Këshilli i Qarkut në mbledhjen e dt. 13.04.2023 pasi mori në shqyrtim vendimin e Kryesisë nr. 01, dt. 21.02.2023 "Për miratimin e treguesve buxhetor të vitit 2022, të Keshillit të Qarkut Dibër, me 10 (dhjetë) vota pro,

V E N D O S I:

1. Miratimin e treguesve buxhetor të vitit 2022, të Keshillit të Qarkut Dibër.
2. Vendimi të dërgohet pranë institucionit të Prefektit për verifikimin e ligjshmërisë.
3. Me ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi ngarkohet GMS, dhe Sektori i Financës.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.
5. U shpall sot, me datë 13.04.2023.

KRYETAR

Valentina Haliti




Kopje





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I QARKUT  
DIBËR



Nr. 81/2 prot.

Peshkopi, më 13. 04.2023

VENDIM

Nr. 02, date 13.04. 2023

**“PËR MIRATIMIN E KALENDARIT TË AKTIVITETEVE ARTISTIKE, KULTURORE,  
SOCIALE, SPORTIVE E PROMOVUESE PËR VITIN 2023”**

Mbështetur në Ligjin nr. 139/2015 dt. 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, neni 77, gërma “k”, neni 82, gërma “b”, në VKM nr. 1173, datë 06.11.2009 “Për përcaktimin e rregullave për organizimin e ngjarjeve kulturore, artistike dhe sociale nga organet e qeverisjes qendrore dhe institucionet e tjera publike, të pavarura”, Këshillit i Qarkut Dibër në mbledhjen e datës 13.04.2023, pasi shqyrtoi Vendimin e Kryesisë “Për miratimin e kalendarit të aktiviteteve artistike, kulturore, sociale, sportive e promovuese për vitin 2023”, me **10 vota pro**,

V E N D O S I :

1. Të miratojë kalendarin e aktiviteteve artistike, kulturore, sociale, sportive e promovuese për vitin 2023 sipas **lidhjes 1** që i bashkëlidhet këtij Vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
2. Aktivitetet e mësipërme do të organizohen nga njësitë e qeverisjes vendore të nivelit të parë me pjesëmarjen, në disa raste në bashkëpunim, me Këshillin e Qarkut.
3. Për aktivitetet e përbashkëta me bashkitë ngarkohet Kryetari i Këshillit të Qarkut për nënshkrimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit.
4. Vendimi ti dërgohet institucionit të Prefektit për verifikimin e ligjshmërisë.
5. Me zbatimin e këtij Vendimi ngarkohen Kabineti i Kryetarit dhe Sektori Juridik dhe Projekteve.
6. Ky Vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.
7. U shpall në Peshkopi, sot datë 13.04.2023.

KRYETAR

Valentina Haliti





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I QARKUT DIBËR

VENDIM

Nr. 03 Datë 13.04.2023

PËR

MIRATIMIN E TAVANEVE PËRGATITORE PËR PROGRAMIN BUXHETOR  
AFATMESËM 2024-2026

Mbeshtetur ne, Ligjin nr.139/2015 “Për veteqeverisjen vendore”, i ndyshuar neni 82 pika 2, Ligjit nr. 68/2017 “Për financat e veteqeverisjes vendore”, i ndyshuar, neni 33 pika 2, Ligjit nr.9936, date 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 6 date 28.02.2023 “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2024-2026”, Këshilli i Qarkut në mbledhjen e dt. 13.04.2023, pasi mori në shqyrtim vendimin e Kryesisë nr. 03, dt. 21.02.2023, “Për miratimin e tavaneve përgatitore të projekt-buxhetit afatmesëm 2024-2026, të Këshillit të Qarkut Dibër, me 10 (dhjetë) vota pro,

V E N D O S I:

1. Miratimin e tavaneve përgatitore dhe tabelave për programin buxhetor afatmesëm 2024-2026.
2. Vendimi të dërgohet pranë institucionit të Prefektit për verifikimin e ligjshmërisë.
3. Me ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi ngarkohet GMS, dhe Sektori i Financës.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.
5. U shpall sot, me datë 13.04.2023.

KRYETAR

Valentina Haliti







REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I QARKUT DIBËR

Nr. 81/ç prot.

Peshkopi, më 13.04.2023

**VENDIM**

Nr. 04 Datë 13.04.2023

**P Ë R**

**VLERËSIMIN PERSONALITET I QARKUT DIBËR PËR  
Z. XHEMAL HARUN DOMI (PAS VDEKJES)**

Mbështetur në ligjin nr.139/2015, dt 17.12.2015, "Për Vetëqeverisjen Vendore", i ndryshuar, neni 77 pika "ll" dhe 82/1, pika "b", Këshillit të Qarkut Dibër në mbledhjen e dates 13.04.2023, pasi mori në shqyrtim Projekt Vendimin Nr. 04, datë 13.04.2023, paraqitur nga kryesiapër vlerësimin si **Personalitet i Qarkut Dibër të z.Xhemal Harun Domi (pas vdekjes) me motivimin "Për kontributin e dhënë në fushën e arsimit dhe pasqyrimin e historisë Dibrane me 10 (dhjetë) vota pro,**

**VENDOSI:**

- 1-Miratimin e propozimit për vlerësimin si **Personalitet i Qarkut Dibër të z.Xhemal Harun Domi (pas vdekjes) me motivimin "Për kontributin e dhënë në fushën e arsimit dhe pasqyrimin e historisë Dibrane"**.
- 2-Ceremonia për këtë vlerësim të organizohet në muajin qershor 2023.
- 3-Me ndjekjen dhe zbatimin e këtij projekt vendimi ngarkohet Sektori Juridik dhe i Projekteve.
- 4-Vendimi të dërgohet pranë institucionit të Prefektit për verifikimin e Ligjshmërisë.
- 5- Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.
- 6- U shpall me dt 13/04/2023.

**KRYETAR**

**Valentina Haliti**







REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I QARKUT DIBËR

VENDIM

Nr. 05 Datë 13 . 04.2023

PËR

**MIRATIM NDRYSHIM ZËRASH BUXHETOR DHE TRANSFERIM FONDI  
BASHKISË DIBËR, MAT, KLOS PËR PËRGATITJET PËR FESTIVALIN E  
GJIROKASTRËS 2023**

Mbeshtetur ne, Ligjin nr.139/2015 “Per veteqeverisjen vendore”, i ndryshuar, Ligjit nr. 68/2017 “Per financat e veteqeverisjes vendore” i ndryshuar, neni 33 pika 2, Ligjit nr.9936, date 26.06.2008 “Per menaxhimin e sistemit buxhetore ne Republiken e Shqiperise”, i ndryshuar, Ligjit nr. 2021 “Për buxhetin e vitit 2023”, në zbatim të Udhëzimit Plotësues nr. 9, dt. 20.03.2018 ”Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, *Vendimit të Këshillit të Qarkut Dibër nr. 17, datë 20.12.2022* “Për miratimin e Buxhetit të K.Q Dibër për vitin 2023”, i ndryshuar, Këshilli i Qarkut në mbledhjen e dt. 13.04.2023 pasi mori në shqyrtim vendimin e Kryesisë nr. 05, dt. 13.04.2023, “Për ndryshim zërash buxhetor dhe transferim fondi Bashkive Diber, Mat, Klos për përgatitjet për përgatitjet për Festivalin e Gjirokastrës me 10 ( dhjetë ) vota pro.

V E N D O S I:

1. Miratimin e ndryshimit të zërave buxhetor si më poshtë:

**Të pakësohet:**

Kap. 602, Artkulli 6027400                      1 300 000 lekë  
Të tjera transferime

**Të shtohet:**

Kap 604, Artikulli 6040001                      1 300 000 lekë

2. Të bëhet transferimi në shumën 1 300 000 lekë :

- Bashkisë Dibër    600 000 lekë
- ,Bashkisë Mat    400 000 lekë
- Bashkisë Klos    300 000 lekë, për përgatitjet për Festivalin e Gjirokastrës.



3. Të miratojë ndryshimet për këto zëra në PASQYRAT 1, 3, 4, të buxhetit të KQ Dibër
4. Me ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Sektori Juridik dhe Projekteve, dhe Sektori i Financës.
5. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.
6. U shpall sot, me datë 13,04.2023.

**KRYETAR**

**Valentina Haliti**





V. No. 6  
(Kryesia + Këshilli)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I QARKUT DIBËR

Nr. 84/6/2 prot.

Peshkopi, më 13.04.2023

VENDIM

Nr. 06 Datë 13.04.2023

P Ë R

**VLERËSIMIN PERSONALITET I QARKUT DIBËR  
PËR**

**Z. TAJAR HALIL DOMI**

Mbështetur në ligjin nr.139/2015, dt 17.12.2015, "Për Vetëqeverisjen Vendore", i ndryshuar, neni 77 pika "l" dhe 82/1, pika "b", Këshillit të Qarkut Dibër në mbledhjen e dates 13.04.2023, pasi mori në shqyrtim Projekt Vendimin Nr. 06, datë 13.04.2023, paraqitur nga kryesia për vlerësimin si **Personalitet i Qarkut Dibër të z.Tajar Halil Domi me motivimin "Intelektual, kontribues i vazhdueshëm në mbajtjen gjallë të lidhjeve shpirtërore e kulturore të zonave tona me diasporën me 10 (dhjetë) vota pro,**

VENDOSI:

- 1-Miratimin e propozimit për vlerësimin si **Personalitet i Qarkut Dibër të z.Tajar Halil Domi me motivimin "Intelektual, kontribues i vazhdueshëm në mbajtjen gjallë të lidhjeve shpirtërore e kulturore të zonave tona me diasporën"**.
- 2-Ceremonia për këtë vlerësim të organizohet në muajin qershor 2023.
- 3-Me ndjekjen dhe zbatimin e këtij projekt vendimi ngarkohet Sektori Juridik dhe i Projekteve.
- 4-Vendimi të dërgohet pranë institucionit të Prefektit për verifikimin e Ligjshmërisë.
- 5- Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.
- 6- U shpall me dt 13 / 04/2023.

KRYETAR

Valentina Haliti







REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I QARKUT DIBËR

Nr. 134 prot.

Peshkopi, më 05.07.2023

VENDIM

Nr. 07 Datë 05.07.2023

PËR

**ZGJEDHJEN E KRYETARIT TË KËSHILLIT TË QARKUT DIBËR**

Mbështetur në ligjin nr.139/2015, dt 17.12.2015, “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar, neni 73,74,75 dhe 77 në Raportin e Komisionit të Mandateve, në proces-verbalin e Komisionit të Votimit, Këshilli i Qarkut Dibër në mbledhjen e dates 05.07.2023, me 17(shtatëmbëdhjetë) vota pro,

VENDOSI:

- 1.Zgjedhjen e **znj. Alma Selami**, në pozicionin e Kryetarit të Këshillit të Qarkut Dibër.
2. Ky vendim të dërgohet për njoftim pranë institucionit të Prefektit Qarkut Dibër.
3. Me këtë vendim të njihet **znj. Alma Selami** dhe jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga njoftimi, të dorëzoj pranë ILDKPI-së formularin “ Deklaratën e interesave private para fillimit të detyrës”.
4. Me zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Sekretari i Këshillit të Qarkut Dibër dhe Sektori i Financës.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**DREJTUESI I MBLEDHJES**

Tahir Damzi







REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I QARKUT DIBËR

Nr. 134/1 prot.

Peshkopi, më 05.07.2023

VENDIM

Nr. 08 Datë 05.07.2023

PËR

ZGJEDHJEN E ZËVENDËSKRYETARIT TË KËSHILLIT TË QARKUT  
DIBËR

Mbështetur në ligjin nr.139/2015, dt 17.12.2015, "Për Vetëqeverisjen Vendore", i ndryshuar, neni 73,74,75 dhe 77 në Raportin e Komisionit të Mandateve, në procesverbalin e Komisionit të Votimit, Këshilli i Qarkut Dibër në mbledhjen e dates 05.07.2023, me 17 (shtatëmbëdhjetë) vota pro,

VENDOSI:

- 1.Zgjedhjen e **z. Armand Gjini** në pozicionin e Zëvendëskryetarit të Këshillit të Qarkut Dibër.
2. Ky vendim të dërgohet për njoftim pranë institucionit të Prefektit Qarkut Dibër.
3. Me këtë vendim të njihet **z.Armand Gjini**.
4. Me zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Sekretari i Këshillit të Qarkut Dibër dhe Sektori i Financës.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Alma Selami







REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I QARKUT DIBËR

Nr. 134/2 prot.

Peshkopi, më 05.07.2023

VENDIM

Nr. 09 Datë 05.07.2023

PËR

**ZGJEDHJEN E KRYESISË TË KËSHILLIT TË QARKUT DIBËR**

Mbështetur në ligjin nr.139/2015, dt 17.12.2015, "Për Vetëqeverisjen Vendore", i ndryshuar, neni 73,74,75, 77 dhe 81, pika 1 në Raportin e Komisionit të Mandateve, në procesverbalin e Komisionit të Votimit, Këshilli i Qarkut Dibër në mbledhjen e dates 05.07.2023, me 16(gjashtëmbëdhjetë) vota pro,

**VENDOSI:**

1.Zgjedhjen e kryesisë së Këshillit të Qarkut Dibër me këtë përbërje:

<b>Alma Selami</b>	<b>Kryetar</b>
<b>Armand Gjini</b>	<b>Zëvendëskryetar</b>
<b>Rahim Spahiu</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Agron Malaj</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Valbona Kola</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Festime Mjeshtri</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Erjon Gjestila</b>	<b>Anëtar</b>

2. Ky vendim të dërgohet për njoftim pranë institucionit të Prefektit Qarkut Dibër.
3. Me këtë vendim të njihen anëtarët e kryesisë.
4. Me zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Sekretari I Këshillit të Qarkut Dibër dhe Sektori i Financës.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR**

**Alma Selami**

